Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

U skladu sa ovlašćenjima datim u članu 64.2 (a) i (b) Zakona br. 03 / L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, Centralna izborna komisija na svom redovnom sastanku održanim 20.09.2021. godine donela je sledeće:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
20 -09- 2021
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 2320-2021

**O D L U K A**

**Za usvajanje Procedura za Primo-Predaju Izbornog Materijala na dan Izbora iz BO-a u Skladište OIK-a**

I. Usvajaju se Procedure za primo-predaju izbornog materijala na Dan izbora iz BO-a u skladište OIK-a.

II. Procedure kao u tački I, sastavni su deo ove odluke.

III. Ova odluka stupa na snagu na dan potpisivanja iste.

Priština, 20.09.2021

Predsedavajući Centralne izborne komisije

Kreshnik Radoniqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

# PROCEDURAT E PRANIM-DORËZIMIT TË MATERIALEVE ZGJEDHORE NË DITËN E ZGJEDHJEVE NGA KVV NË DEPOT E KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

## Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

## Pasqyra e lëndës


I. Përmbledhja e shkurtesave/akronimeve të përdorura ..... 3

II. Roli i anëtarëve të KKZ-së në pranim të materialit zgjedhore në Qendër të KKZ-së ..... 4

III. Pranimi i materialit nga VV të Rregullta dhe të Dyfishta në KKZ ..... 5

IV. Hapat e pranimit të materialeve nga vendvotimet e rregullta ..... 7

V. Hapat e procesit të pranimit të materialeve nga vendvotimet e dyfishta ..... 8

VI. Përgatitja e materialeve të Vendvotimeve për dërgim në QNR ..... 9

VII. Kompletimi i materialeve ..... 9

VIII. Arkivimi i materialeve ..... 9

IX. Përgatitja për procesin e pranimit të materialeve nga Ekipet Mobile të Votimit të Personave me Nevojave dhe Rrethanat e Veçanta (VPNRV) ..... 11

X. Hapat e procesit të pranimit të materialeve nga Ekipet Mobile (VPNRV) ..... 11

XI. Paketimi i Materialeve të VPNRV-ve për transport në QNR ..... 11

XII. Paketimi / Transporti i të gjitha materialeve të ndjeshme për në QNR ..... 11

XIII. Shtojca 1: Strukturimi i materialeve në qendrën e pranimit të KKZ-së ..... 13

XIV. Shtojca 2: Vendvotimi i rregullt ..... 14

XV. Shtojca 3: Vendvotimi i dyfishtë ..... 15

XVI. Shtojca 4: Vendvotimi i VPNV-së ..... 16

XVII. Shtojca 5: Raporti I KKZ-së mbi pranimin e materialeve ..... 17

XVIII. Shtojca 6: Raporti I KKZ-së mbi pranimin e materialeve VPRNV-së ..... 19

XIX. Shtojca 7: Formulari I dorëzimpraninmit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK) ..... 21

XX. Shtojca 8: Raporti i qendrës së numërimit dhe të rezultateve mbi pranimin e materialeve ..... 22

## I. Përmbledhja e shkurtesave/akronimeve të përdorura:

*KV:* Kutia e votimit
*ZFK:* Zarfi i fletëvotimeve me kusht
*FPR:* Formulari i përputhjes së rezultateve
*FRK:* Formulari i rezultateve të kandidatit
*LVP:* Lista përfundimtare e votuesve
*LVK:* Lista e votuesve me kusht
*KRK:* Kryetare Komune
*KKO:* Kuvendi Komunal
*KKZ:* Komisioni komunal i zgjedhjeve
*QV:* Qendra e Votimit
*VV:* Vendvotimi
*KVV:* Këshilli i vendvotimit
*FP:* Formulari i përputhjes së të dhënave
*VPNRV:* Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta

## II. Roli i anëtarëve të KKZ-ve në pranim të materialit zgjedhor në Depo të KKZ-së

Roli i anëtarëve të KKZ-së është, të pranojnë materialet e ndjeshme dhe jo të ndjeshme, përfshirë të gjitha format dhe materialet e paketimit nga Kryesuesi i Këshillit të VV dhe një anëtari tjetër. Duke pranuar materialet e Vendvotimit, anëtarët e pranimit do të kontrollojnë materialin duke përdorur një formular të veçantë që quhet **KKZ RAPORT I PRANIMIT**. Pas pranimit të këtyre materialeve nga KVV ne Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, këto materiale do te arkivohen në një zonë të caktuar, që me pastaj të tilla të procedohen për në Qendrën e Numërimit dhe rezultateve. KKZ pas grumbullimit te materialeve nga te gjitha KVV fillon përgatitjen për transportin e materialeve në QNR.

Çdo Kryesues i Këshillit të Vendvotimit duhet të jetë prezent për të ndihmuar KKZ-në gjatë tërë procesit të pranimit në KKZ për VV e tyre përkatëse.

Pranimi dhe verifikimi i materialeve sipas udhëzuesve gjegjës të procedurave, përgatitja dhe sistemimi i mirë i materialeve nga Vendvotimet dhe Ekipet mobile, janë vendimtare për dhënien e rezultateve të sakta dhe në kohë.

**Prandaj, KKZ-të duhet të sigurohen që KVV-të janë duke përmbushur detyrimet e tyre kur i dorëzojnë materialet në KKZ. Pasi përfaqësuesit e KVV-ve dhe KKZ-ve të kenë nënshkruar dokumentin e pranim-dorëzimit, KKZ janë përgjegjës për saktësinë e materialit. Qendra për Numërim dhe Rezultate do të kontrollojë saktësinë e materialit dhe më pas do të raportojë dhe iniciojë sanksione për çdo shkelje të procedurave.**

**Gjatë pranimit të materialit në KKZ ndërhyrja në korrigjim lejohet vetëm në këto raste:**

- Korrigjimi për paketim të gabuar;
- Mbulimi i materialeve të ndjeshme që mungojnë në nivel më të afërt VV; dhe
- Plotësimi i rubrikave bosh të FPR-ve dhe FRK-së ( me laps të gjelbër) me të dhënat që janë në zarfet dhe thasët gjegjës nëpër Kutitë e VV (Shikimi vizual), por që nuk përfshijnë verifikimet apo llogaritjet matematikore.

## III. Pranimi i materialit nga Vendvotimet e Rregullta dhe të Dyfishta në KKZ

Nëse një anëtarë i KKZ-së, korrigjon apo ndryshon të dhëna për një artikull, ai duhet ta evidentoj me stilolaps ngjyrë të gjelbër dhe në afërsi të ndryshimit apo korrigjimit që ka bërë do t'i vejë emrin, mbiemrin e tij dhe numrin identifikues të SKQZ-së (distinktivit).

### Përgatitja për procesin e pranimit të materialeve në KKZ

Për pranimin e materialeve të cilat Kryesuesit e KVV-ve i sjellin në Depot e KKZ-ve, në nivelin Komunal bëhen përgatitjet me artikujt e nevojshëm si në vijim:

1. Udhëzuesin/Procedurat e Pranim-Dorëzimit;
2. Formulari i raportimit për pranim dorëzim i kompletuar për çdo VV të përpunuar nga Zyrtari i Pranimit;
3. Stilolapsa të gjelbër, marker të zi, stikersa të zi të dy madhësive;
4. Formulari i pranim-dorëzimit të fletëve llogaritëse të kandidatëve;
5. Zarfe të QNR-së për çdo VV që pranohet;
6. Zarfe të QNR-së për VPNRV;
7. Etiketa të VV-ve dhe Kutive të Votimit;
8. Qese të tejdukshme të QNR-së;
9. Thesi i QNR-së;
10. Dosje kartoni për paraqitjen e Kopjeve të Gjelbra të FPR-ve dhe FRK-së të përmbledhjeve të rezultateve.

### Procesi i pranimit te materialeve nga vendvotimet e rregullta

Çdo Kryesues së bashku me një anëtarë nga vendvotimet e rregullta, është i obliguar të dorëzoj në KKZ gjithsej pesë (5) artikuj:

1. Një Kuti votimi të mbyllur për Kryetar Komune;
2. Një Kuti votimi të mbyllur për Kuvend Komunal;
3. Zarfi i KKZ-së duhet të përmbajë këta artikuj:
   - Lista Përfundimtare e Votuesve(LPV)
   - Libri i Votimit;
   - FPR për Zgjedhjet për Kuvend Komunal;
   - FPR për Zgjedhjet për Kryetar Komune;
   - FRK për Zgjedhjet për Kuvendin Komunal;
   - Fletët llogaritëse të kandidatëve (FLLK).
4. Thesi me material administrativ; dhe
5. Qese me:
   - Vula;
   - UV Llamba; dhe
   - Spreji

KKZ duhet të pranoj artikujt e lart shënuar nga anëtarët duke e plotësuar Raportin e Pranimit ne rubrikat përkatëse. Kryesuesi dhe anëtari i KKZ-së që bënë pranimin e materialeve janë të obliguar të nënshkruhen ne raportin e KKZ-së për pranim-dorëzimin e materialeve nga vendvotimet në Depon e KKZ-së.

**Procesi i pranimit te materialeve nga vendvotimet e dyfishta**

Çdo Kryesues së bashku me një anëtarë nga vendvotimet i dyfishtë, është i obliguar të dorëzoj në KKZ gjithsej gjashtë (6) artikuj:

1. Një Kuti votimi të mbyllur për Kryetar Komune;
2. Një Kuti votimi të mbyllur për Kuvend Komunal;
3. Thesi i mbyllur me zarfet e fletëvotimeve me kusht
4. Zarfi i KKZ-së;
   - Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV)
   - Lista e Votuesve me Kusht (LVK)
   - Libri i Votimit;
   - FPR për Zgjedhjet për Kuvend Komunal;
   - FPR për Zgjedhjet për Kryetar Komune;
   - FRK për Zgjedhjet për Kuvendin Komunal;
   - Fletët llogaritëse të kandidatëve (FLLK).
5. Thesi me material administrativ; dhe
6. Qese me:
   - Vula,
   - UV Llamba dhe
   - Spreji

KKZ duhet të pranoj artikujt e lart shënuar nga anëtarët duke e plotësuar Raportin e Pranimit ne rubrikat përkatëse. Kryesuesi dhe anëtari i KKZ-së që bënë pranimin e materialeve janë të obliguar të nënshkruhen ne raportin e KKZ-së për pranim-dorëzimin e materialeve nga vendvotimet në Depon e KKZ-së.

## IV. Hapat e pranimit të materialeve nga vendvotimet e rregullta

### Hapi-1

Procesi i pranimit fillon me kontrollin vizual të kutive, thesin me material administrativ, Qesja (Vulë, sprej dhe llambë), pa i hapur ato si dhe me hapjen e Zarfit të KKZ-së. Varësisht cila kuti është, ato duhet të përbëjnë artikujt si në vijim:

a. **Kutia e votimit për Kryetar Komune:**
   i. Zarfin 1-Fletëvotime të dëmtuara;
   ii. Zarfin 3-Fletëvotime të pa plotësuara dhe të pavlefshme;
   iii. Thesin 2-Fletëvotime të pa përdorura;
   iv. Thesin 4-Fletëvotimet e vlefshme të numëruara;

b. **Kutia e votimit për Kuvend Komunal:**
   i. Zarfin 1-Fletëvotime të dëmtuara;
   ii. Zarfin 3-Fletëvotime të pa plotësuara dhe të pavlefshme;
   iii. Thesin 2-fletëvotime të pa përdorura, dhe amat e fletëvotimeve;
   iv. Thesin 4-Fletëvotimet e vlefshme të numëruara;
   v. Fletët Llogaritëse (FLK).

- **Thesi me materiale administrative dhe**
- **Qese (Vulë, sprej dhe UV llamba)**

### Hapi-2

Hapja e zarfit të KKZ-së.
Për vendvotimet e rregullta, Zarfi i KKZ-së duhet t'i ketë këta artikuj:

- Lista e Votuesve;
- Libri i Votimit;
- FPR për Kryetar Komune;
- FPR për Kuvend Komunal;
- FRK;
- Fletët llogaritëse të kandidateve( FLLK).

### Hapi-3

Kontrollimi/Verifikimi i të dhënave në FPR, FRK dhe Formulari i dorëzimpranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK).Kontrollohet numri i shiritave të regjistruar në pjesën dytë (2) të FPR-së dhe krahasohet me numrin e shiritave në Kutitë e Votimit.

vi. Kontrollohen të dhënat në FPR-të, dhe verifikon se a janë plotësuar të gjitha rubrikat si dhe a janë nënshkruar të gjithë anëtarët e KVV-së. Njëkohësisht, nga FPR-të shkëputet kopja indigo e gjelbër dhe vendoset në dosje Kartoni të madhësisë A4, që në fund të procesit të mblidhen të dhënat tabelore të rezultateve të zgjedhjeve.

vii. KKZ bënë verifikimin e të dhënave në Formularin e dorëzimpranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK) dhe në fund kryesuesi I KVV-së dhe anëtari I KKZ-së nënshkruhen në rubriakt përkatëse.

## V. Hapat e procesit të pranimit të materialeve nga vendvotimet e dyfishta

### Hapi-1

Procesi i pranimit fillon me kontrollin vizual të kutive, thesin me material administrativ, Qesja (Vulë, sprej dhe llambë), pa i hapur ato si dhe me hapjen e Zarfit të KKZ-së. Varësisht cila kuti është, ato duhet të përbëjnë artikujt si në vijim:

a. **Kutia e votimit për Kryetar Komune:**
   i. Zarfin 1-Fletëvotime të dëmtuara;
   ii. Zarfin 3-Fletëvotime të pa plotësuara dhe të pavlefshme;
   iii. Thesin 2-Fletëvotime të pa përdorura;
   iv. Thesin 4-Fletëvotimet e vlefshme të numëruara;

b. **Kutia e votimit për Kuvend Komunal:**
   i. Zarfin 1-Fletëvotime të dëmtuara;
   ii. Zarfin 3-Fletëvotime të pa plotësuara dhe të pavlefshme;
   iii. Thesin 2-fletëvotime të pa përdorura, dhe amat e fletëvotimeve;
   iv. Thesin 4-Fletëvotimet e vlefshme të numëruara;
   v. Fletët Llogaritëse (FLK).

- **Thesi i Zarfeve të Fletëvotimeve me kusht***
  **(Ky thes **NUK** hapet në nivel të KKZ-së. Materiali ashtu siç është, pranohet në KKZ dhe procedohet për në QNR).*
- **Thesi me materiale administrative; dhe**
- **Qese (Vulë, sprej dhe UV llamba).**

### Hapi-2

Hapja e zarfit të KKZ-së.
Për vendvotimet e dyfishta, Zarfi i KKZ-së duhet t'i ketë këta artikuj:

- Lista e Votuesve;
- Lista e Votuesve me Kusht;
- Libri i Votimit;
- FPR për Kryetar Komune;
- FPR për Kuvend Komunal;
- FRK;
- Fletët llogaritëse të kandidateve( FLLK).

### Hapi-3

Kontrollimi/Verifikimi i të dhënave në FPR, FRK dhe Formulari i dorëzimpranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK).

vi. Kontrollohet numri i shiritave të regjistruar në pjesën dytë (2) të FPR-së dhe krahasohet me numrin e shiritave në Kutitë e Votimit si dhe numri i shiritit të thesit të Zarfeve të Fletëvotimeve me kusht (ZFK).

vii. Kontrollohen të dhënat në FPR-të, dhe verifikon se a janë plotësuar të gjitha rubrikat si dhe a janë nënshkruar të gjithë anëtarët e KVV-së. Njëkohësisht, nga FPR-të shkëputet kopja indigo e gjelbër dhe vendoset në dosje Kartoni të madhësisë A4, që në fund të procesit të mblidhen të dhënat tabelore të rezultateve të zgjedhjeve.

viii. KKZ bënë verifikimin e të dhënave të Formularit të dorëzimpranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK).

## VI. Përgatitja e materialeve të Vendvotimeve për dërgim në QNR

Nga çdo stacion ku përgatitet materiali për dërgim në QNR duhet të jenë këta artikuj:

- Zarfi i QNR-së:
  - Lista Përfundimtare e Votuesve
  - Lista e Votueseve me Kusht (vetëm në VV të dyfishtë)
  - Libri i Votimit
  - FPR për Kryetar Komune
  - FPR për Kuvend Komunal
  - FRK
  - Fletët llogaritëse të Kandidatëve (FLLK)

- Formulari i dorëzimpranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK).
- Një Kuti votimit për Kryetar Komune;
- Një Kuti votimit për Kuvend Komunal;
- Një Indigo kopje e bardhë e Raportit të Pranimit të KKZ-së;
- Thesi me material administrativ; dhe
- Qese (Vula, Spreji dhe Llamba)

**PËR VV TË DYFISHTË**- përgatitet thesi i QNR-së i cili duhet të përbëjë artikujt si në vijim:

- Zarfin e QNR-së
- Thesin e ZFK-ve
- Raportin e Pranimit të KKZ-së (kopja e bardhë).

## VII. Kompletimi i materialeve

Pas kompletimit të formularit të raportit të pranimit të KKZ-së, Zyrtari i pranimit në KKZ firmos **Raportin e pranimit të KKZ-së,** Kryesuesi i KVV-së e vë emrin, mbiemrin, nënshkrimin dhe më pastaj atij i jepet indigo kopje rozë dhe është i lirë të largohet.

## VIII. Arkivimi i materialeve

**Zyrtari i Pranimit në KKZ** arkivon materialet e vendvotimeve në zonën e caktuar dhe përgatitë artikujt e VV për transportim në lokacionin e **QNR-së.** *(shih shtojcën 1)*

## Skenarët e mundshëm gjatë PRANIMIT

**SKENARET** → **VEPRIMET**

### Nëse një artikull mungon

1. KKZ plotëson "Rubrikën e Artikujve që mungojnë" në Raportin e Pranimit të KKZ-së dhe përshkruan artikullin/artikujt që mungojnë dhe përpjekjet të cilat i ka bërë për ti ri-gjetur ato.
2. Stikers (afishe) i vogël i zi është ngjitur në Zarfin e QNR-së dhe në fletën e punës së FPR-ve dhe FRK-së (origjinali dhe kopja)
3. Stikers (afishe) i madh i zi është ngjitur në Thesin e QNR- së vetëm në rast të VV të Dyfishtë dhe në Kutinë e Votimit.
4. Nëse Kutitë e Votimit janë hapur, ato janë vulosur dhe shiritat janë regjistruar me stilolaps të gjelbër në Raportin e Pranimit të KKZ-së dhe në FPR-të.
5. Udhëzohet Kryesuesi të ri-gjejë artikullin/artikujt që mungojnë menjëherë.
6. Kutitë e Votimit duhet të ruhen në një vend të sigurt deri sa të kthehet Kryesuesi i VV. Nëse artikulli/artikujt janë gjetur ata janë shënjuar në "Rubrikën e Artikujve që mungojnë" të Raportit të Pranimit të KKZ-së. Artikujt e gjetur janë vendosur në paketën e përshtatshme, e cila më pastaj është ri-vulosur. Numrat e rinj të shiritave të sigurisë janë regjistruar në Raportin e Kryesuesit të KVV dhe Zyrtarit të pranimit t ë KKZ-së.

### Nëse FPR-të apo FRK nuk janë plotësuar krejtësisht.

- Një kontroll vizual i fletës së punës dhe Kutisë se Votimit mund të lejon kopjimin e totalit të shënuar në zarfe për të plotësuar informacionet që mungojnë.
- Nëse totali në zarfe dhe thasë nuk është i dukshëm, Kutia e Votimit mund tëhapet dhe të mbyllet sërish. Numrat e rinj të lidhëseve regjistrohen në Raportin e Pranimit të KKZ-së dhe në FPR-të.

### Nëse numrat e Shiritave të sigurisë së Kutisë së Votimit janë thyer/mungojnë apo ndryshojnë nga ato të regjistruara në FPR.

- Kryesuesi i KVV është intervistuar dhe deklarata e tij/saj është regjistruar në Raportin e Pranimit të KKZ-së. Gjithashtu është konsultuar Libri i Votimit.
- Në rast se duhet të aplikohen lidhëse të reja të sigurisë, atëherë numrat e lidhëseve të sigurisë të ri-regjistrohen nga Zyrtari i Pranimit në KKZ në FPR me stilolaps të GJELBËR.
- Stikersi **i MADH I ZI** ngjitet në Kutinë e Votimit.

### Nëse mungojnë nënshkrimet në FPR-të dhe FRK.

Kryesuesi i KVV duhet të mbledh nënshkrimet që mungojnë nga anëtarët e KKV-së në fjalë. Nëse mungesa e anëtarit ka qenë e justifikuar kjo do të merret parasysh në Rubrikën e Artikujve që mungojnë të Raportit të Pranimit të KKZ-së.

### Nëse kontrolli vizual nuk lejon të konstatohet përmbajta e Kutisë së Votimit.

Kutia e Votimit është hapur për të verifikuar përmbajtjen dhe tani është mbyllur përsëri. Numrat e rinj të lidhëseve të sigurisë do të regjistrohen në rubrikën përkatëse në raportin e pranimit të KKZ-së dhe në FPR-të.

### Nëse numri i Lidhëseve të sigurisë së thesit të ZFK-së mungon ose dallon nga ai i shënuar në FPR-të

Kryesuesi i KVV është intervistuar dhe deklarata e tij/saj është regjistruar në Raportin e pranimit të KKZ-së . Anëtari i KKZ-së korrigjon numrat e lidhësve të sigurisë në FPR me stilolaps të GJELBËR dhe vendos një stikers (afishe) të MADH TË ZI në thesin e ZFK -së.

## IX. Përgatitja për procesin e pranimit të materialeve nga Ekipet Mobile të Votimit të Personave me Nevojave dhe Rrethanat e Veçanta (VPNRV)

**Artikujt e nevojshëm për këtë fazë janë:**

- Udhëzuesin/Procedurat e Pranim-Dorëzimit;
- Formulari i Përputhjes (FP);
- Lapsa, Kimik të GJELBËR, marker me ngjyrë të zezë, stikers i zi (madhësia e vogël/e madhe);
- Zarfe të VPNRV/NJË për ekip të VPNRV;
- Qese e QNR-së për VPNRV.

Kur ekipet e VPNRV kanë shërbyer votuesit e tyre në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i Ekipit të VPNRV dërgon tëgjithë materialet zgjedhore në KKZ. *(shih shtojcën 4)*

<u>Nga çdo ekip i VPNRV-së KKZ duhet të pranoj artikujt si në vijim</u>:

- **Zarfin e KKZ-së me material të VPNRV që përmban:**
  - ➢LVK;
  - ➢Librin e Votimit;
  - ➢Formulari i Përputhjes (FP) i VPNRV;

- **Një thes më material të VPNRV që përmban:**
  - Zarfi 1 (me fletëvotime të dëmtuara) për Kryetar Komune;
  - Thesi 2 (me fletëvotime të papërdorura, amat e fletëvotimeve) për Kryetar Komune;
  - Zarfi 1 (me fletëvotime të dëmtuara) për Kuvend Komunal;
  - Thesi 2 (me fletëvotime të papërdorura, amat e fletëvotimeve) për Kuvend Komunal.

- **NJË KUTI TË VOTIMIT me ngjyrë hiri**
- **Thesi me materiale administrative, dhe**
- **Qese (Vula, spreji dhe UV Llamba)**

## X. Hapat e procesit të pranimit të materialeve nga Ekipet Mobile (VPNRV)

**Hapi 1.**

- KKZ hap zarfin e KKZ-së të VPNRV-ve për të verifikuar kodin e VPNRV / përmbajtjen e dokumenteve ( LVK, Librin e Votimit, FP e VPNRV)

**Hapi 2.**

- Kontrollon të dhënat e regjistruara në Formularin e Përputhjes të VPNRV
- Kontrollon numrin e shiritave të sigurisë të regjistruara në Formularin e Përputhjes të VPNRV
- Kontrollon të dhënat në formularin e përputhjes, nëse mungon ndonjë e dhënë dhe a është i kompletuar si dhe i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Ekipit Mobil.

**Hapi 3.**

- Zyrtari i pranimit në KKZ kompleton Formularin e Përputhjes për VPNRV duke shënjuar rubrikat përkatëse dhe duke nënshkruar formularët, po ashtu të nënshkruhet nga Kryesuesi i Ekipit të VPNRV-së.
- Formulari i Përputhjes për VPNRV > Origjinali është i vendosur brenda Zarfit të QNR-së për VPNRV.
  - ➢ Kopja e bardhë do të shoqëron materialin e VPNRV deri në QNR;
  - ➢ Kopja e gjelbër mbetet në KKZ;
  - ➢ Kopja rozë i jepet Kryesuesit të Ekipit Mobil.

## XI. Paketimi i Materialeve të VPNRV-ve për transport në QNR

Pasi të bëhet pranimi, verifikimi dhe korrigjimi i të gjitha të dhënave nga materialet e Ekipit të VPNRV-së, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve përgatitë materialet për t'i dërguar në QNR sipas përshkrimit në vijim:

- **Thesi i QNR-së me material të VPNRV-së:**
  - ➢ LVK;
  - ➢ Libri i votimit;
  - ➢ Formulari i përputhjes së të dhënave (FP) të VPNRV; dhe
  - ➢ **Thesi i KKZ-së me material të VPNRV-së** (Zarfet 1 dhe Thesi 2 për Kryetar Komune; Zarfet 1 dhe Thesi 2 për Kuvend Komunal të VPNRV-së).

- **Kutia e Votimit me material të VPNRV-së** me etiketë me ngjyrë hiri;

- **Një indigo kopje të Formularit të Përputhjes së të dhënave (FP) të VPNRV;**
- **Thesi me material administrativ; dhe**
- **Qese (Vula, spreji, UV llamba).**

**Artikujt e lartshënuar duhet të transportohen në QNR së bashku me materialet tjera të ndjeshme nga vendvotimet e rregullta, dyfishta dhe VPRNV.**

## XII. Paketimi / Transporti i të gjitha materialeve të ndjeshme për në QNR

Me të mbaruar të pranimit, verifikimit dhe aktiviteteve korrektuese për vendvotimet, KKZ përgatit zarfet e QNR-së (apo qesen e QNR-së në rast të VV të dyfishtë) dhe aranzhon transportin për në QNR .

Anëtarët e KKZ-ve, do të bëjnë transportin e të **gjitha materialeve zgjedhore të ndjeshme** nga Depo e KKZ-së deri në QNR në një dërgesë siç përshkruhet në (shtojcat : 2,3,4 ).

Shtojca 1: Strukturimi i materialeve në qendrën e pranimit të KKZ-së



Shtojca 2: Vendvotimi i rregullt




+



RAPORTI I KKZ-SË MBI PRANIMIN E MATERIALEVE / IZVEŠTAJ OIK-A O PRIJEMU MATERIJALA

Numri i vendvotimit: / Broj biračkog mesta: 0101C / 01R

Zarfi për KKZ / Koverat za OIK

VËREJTJET / PRIMEDBE

Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës / Glasačka kutija za izbore za Gradonačelnika

Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal / Glasačka kutija za izbore za Skupštinu Opštine

MATERIALET QË MUNGOJNË

MATERIJALI KOJI NEDOSTAJU

Kryesuesi i KVV-së / Predsedavajući BO-a

Përfaqësuesi i KKZ-së / Predstavnik OIK-a

Shtojca 3: Vendvotimi i dyfishtë




+



Shtojca 4: Vendvotimi i VPNV-së





RAPORTI I KKZ-SË MBI PRANIMIN E MATERIALEVE / IZVEŠTAJ OIK-A O PRIJEMU MATERIJALA

Numri i vendvotimit: / Broj biračkog mesta: 0101C / 01R

Zarfi për KKZ / Koverat za OIK

VËREJTJET / PRIMEDBE

Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës / Glasačka kutija za izbore za Gradonačelnika

Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal / Glasačka kutija za izbore za Skupštinu Opštine

MATERIALET QË MUNGOJNË

MATERIJALI KOJI NEDOSTAJU

Kryesuesi i KVV-së / Predsedavajući BO-a

Përfaqësuesi i KKZ-së / Predstavnik OIK-a

# RAPORTI I KKZ-SË MBI PRANIMIN E MATERIALEVE
# IZVEŠTAJ OIK-A O PRIJEMU MATERIJALA

KOMUNA / OPŠTINA

| 0 | 1 | |
|---|---|---|

Numri i vendvotimit
Broj biračkog mesta

0 1 0 1 C / 0 1 R

**Origjinali mbetet tek KKZ-ja**

Kopja e rozë (pembe) i jepet kryesuesit të ekipit të numërimit të vendvotimit
Kopja e parë e bardhë ta përcjellë dërgesën e parë për në Qendrën e numërimit dhe të rezultateve

**Original ostaje kod OIK-a**

Roze kopija se daje predsedavajućem tima za prebrojavanje biračkog mesta
Prva bela kopija se šalje sa prvom pošiljkom Centru za prebrojavanje i rezultate

# RAPORTI I KKZ-SË MBI PRANIMIN E MATERIALEVE / IZVEŠTAJ OIK-A O PRIJEMU MATERIJALA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Numri i vendvotimit:
Broj biračkog mesta: 0 1 0 1 C / 0 1 R

| Zarfi për KKZ / Koverat za OIK | ☐ |
|---|---|
| Libri i votimit / Knjiga o toku glasanja | ☐ |
| Lista përfundimtare e votuesve / Konačni birački spisak | ☐ |
| FPR (Formulari i Përputhjes dhe Rezultateve) / OUR (Obrazac za Usklađivanje i Rezultate) — Kryetari i Komunës / Gradonačelnik | ☐ |
| Fleta e punës+origjinali+kopjet / Radni list+original+kopije — Kuvendi Komunal / Skupština Opštine | ☐ |
| FRK (Formulari i Rezultatit të Kandidatëve) / ORK (Obrazac za Rezultate Kandidata) — Kuvendi Komunal / Skupština Opštine | ☐ |
| Origjinali+kopjet / Original+kopije | |
| FLJK (Fletët e pëndoruta përllogaritëse të kandidatëve) / LOGK (Konačni listovi za obračunavanje glasova kandidata) | ☐ |
| +kopjet / +kopije | |

**VËREJTJET / PRIMEDBE**

| Nëse vendvotimi është i dyfishtë / Ako je dvojno biračko mesto | ☐ |
|---|---|
| Lista e votuesve me kusht<br>Birački spisak za uslovno glasanje | ☐ |
| Thesi që përmban zarfe të fletëvotimeve me kusht<br>Vreća koja sadrži koverte sa uslovnim glasačkim listićima | ☐ |
| A janë të sakta numrat e shiritit mbyllës?<br>Da li su brojevi zaštitnog pečata tačno upisani? | ☐ |
| Shënoni numrat e shiritave mbyllës të thesit të Qendrës së numërimit dhe të rezultateve<br>Unesite brojeve traka za zatvaranje vreće Centra za prebrojavanje i rezultate | |

| Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës / Glasačka kutija za izbore za Gradonačelnika | ☐ |
|---|---|
| Zarfi 1 që përmban fletëvotime të dëmtuara / Koverat 1 koji sadrži oštećene glasačke listiće | ☐ |
| Thesi 2 që përmban fletëvotime të papërdorura dhe amat e fletëvotimeve<br>Vreća 2 koja sadrži neiskorišćene glasačke listiće i matice glasačkih listića | ☐ |
| Zarfi 3 që përmban fletëvotime të zbrazëta dhe të pavlefshme / Koverat 3 koji sadrži nepopunjene i nevažeće glasačke listiće | ☐ |
| Thesi 4 që përmban fletëvotime të vlefshme të numëruara / Vreća 4 koji sadrži prebrojane važeće glasačke listiće | ☐ |
| A janë të sakta numrat e shiritave mbyllës? / Da li su tačni brojevi trake za zatvaranje? | ☐ |
| Vula e fletëvotimeve / Pečat za glasačke listiće | ☐ |

| Kutia e votimit e Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal / Glasačka kutija za izbore za Skupštinu Opštine | ☐ |
|---|---|
| Zarfi 1 që përmban fletëvotime të dëmtuara / Koverat 1 koji sadrži neispravne glasačke listiće | ☐ |
| Thesi 2 që përmban fletëvotime të papërdorura, amat e fletëvotimeve dhe fletët e papërdorura llogaritëse të kandidatëve<br>Vreća 2 koja sadrži neupotrebljene glasačke listiće, matice glasačkih listića i neupotrebljene liste za proračunavanje glasova kandidata | ☐ |
| Zarfi 3 që përmban fletëvotime të zbrazëta dhe të pavlefshme / Koverat 3 koji sadrži nepopunjene i nevažeće glasačke listiće | ☐ |
| Thesi 4 që përmban fletëvotime të vlefshme të numëruara / Vreća 4 koji sadrži prebrojane važeće glasačke listiće | ☐ |
| A janë të saktë numrat e shiritave mbyllës? / Da li su brojevi zaštitnih pečata tačno upisani? | ☐ |

**MATERIALET QË MUNGOJNË**
(përshkrimi i arsyeve për mungesën e materialeve, dhe hapat që janë ndërmarrë)

**MATERIJALI KOJI NEDOSTAJU**
(opis razloga za nedostatak materijala i preduzetih koraka)

*Përdorni këtë hapësirë për të nënshkruar nëse materialet që mungojnë janë gjetur dhe janë sjellë tek KKZ-ja*
*Koristite ovaj prostor za potpisivanje ako su pronađeni materijali koji nedostaju i su doneti OIK-u*

**Kryesuesi i KVV-së / Predsedavajući BO-a**
Emri dhe mbiemri / Ime i prezime ______
Nënshkrimi / Potpis ______
Data / Datum ______

**Përfaqësuesi i KKZ-së / Predstavnik OIK-a**
Emri dhe mbiemri / Ime i prezime ______
Nënshkrimi / Potpis ______
Data / Datum ______

**Kryesuesi i KVV-së / Predsedavajući BO-a**
Emri dhe mbiemri / Ime i prezime ______
Nënshkrimi / Potpis ______
Data / Datum ______

**Përfaqësuesi i KKZ-së / Predstavnik OIK-a**
Emri dhe mbiemri / Ime i prezime ______
Nënshkrimi / Potpis ______
Data / Datum ______

## FORMULARI I PËRPUTHJES SË TË DHËNAVE - OBRAZAC ZA USKLAĐIVANJE PODATAKA

**Numri i ekipit të VPNV-së:**
**Broj tima GOPP-a:**

[ ][ ] / [ ][ ] / [ ][ ]

| Kodi Komunal<br>Opštinski kod | Nr. i ekipit<br>Br. Tima | Nr. i kutive të votimit<br>Br. glasačkih kutija |
|---|---|---|

**Votimi i personave me nevoja të veçanta / Glasanje osoba sa posebnim potrebama**

# VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA - GLASANJE OSOBA SA POSEBNIM POTREBAMA

FORMULARI I PËRPUTHJES SË TË DHËNAVE - OBRAZAC ZA USKLAĐIVANJE PODATAKA

**PJESA I - ODELJAK I:**

PLOTËSO PARA HAPJES - POPUNITI PRE OTVARANJA

1 Numri i ekipit të votimit të personave me nevoja të veçanta
Broj ekipe glasanja osoba sa posebnim potrebama

2

3 Numri i fletëvotimeve të pranuara
Broj primljenih glasačkih listića

**PJESA II - ODELJAK II:**

PLOTËSO PAS MBYLLJES SË VENDVOTIMIT - POSLE ZATVARANJA BIRAČKOG MESTA

4

5

6 Numri i fletëvotimeve të papërdorura
Broj neiskorišćenih glasačkih listića

7 Numri i fletëvotimeve të dëmtuara
Broj oštećenih glasačkih listića

8 Gjithsej (5+6+7)
Ukupno (5+6+7)

*Përputhja / Usaglašavanje*

9

10 Broj traka za zatvaranje vreće za GOPP

Svojim potpisom potvrđujem da ove cifre tačno odražavaju aktivnosti ovog tima

Kryesuesi - Predsedavajući | Anëtari - Član | Anëtari - Član

**PJESA III - ODELJAK III:**

RAPORTI I KKZ-SË MBI PRANIMIN E MATERIALEVE - IZVEŠTAJ OIK-A O PRIJEMU MATERIJALA

**KONTROLLI VIZUEL - VIZUELNA PROVERA**

**Materialet që mungojnë - Materijali koji nedostaju**

Potpis predsedavajućeg tima za GOPP

Potpis Predsedavajućeg OIK-a

Shtojca 7: Formulari I dorëzimpraninmit të fletës llogaritëse të kandidatëve (FLLK)

**ZGJEDHJET PËR KUVENDIN KOMUNAL 2021 - IZBORI ZA SKUPŠTINU OPŠTINE 2021 - BELEDİYE MECLİSİ 2021 SEÇİMLERİ**

**FORMULARI I DORËZIMPRANIMIT TË FLETËS LLOGARITËSE TË KANDIDATËVE (FLLK)**
**OBRAZAC PRIMO-PREDAJE LISTA ZA OBRAČUNAVANJE GLASOVA KANDIDATA**
**ADAYLARIN OY HESAPLAMA PUSULALARININ (AOHP) TESLİM ALIM FORMU**

Numri i vendvotimit
Broj biračkog mesta
Oylama yeri numarası
☐☐☐☐☐ / ☐☐☐

**KOMUNA**

| **01 DEÇAN / DEČANE** | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
|---|---|---|---|
| **ARJEN ROBBEN** FC BAYERN MÜNCHEN AG | ☐ | ☐ | ☐ |
| **LIONEL MESSI** FC BARCELONA | ☐ | ☐ | ☐ |
| **GARETH BALE** FC REAL MADRID | ☐ | ☐ | ☐ |
| **ALEXIS SÁNCHEZ** FC ARSENAL | ☐ | ☐ | ☐ |
| **HENRIKH MKHITARYAN** MANCHESTER UNITED | ☐ | ☐ | ☐ |
| **ROBERT LEWANDOWSKI** FC BAYERN MÜNCHEN AG | ☐ | ☐ | ☐ |
| **PAUL POGBA** MANCHESTER UNITED | ☐ | ☐ | ☐ |
| **MANUEL NEUER** FC BAYERN MÜNCHEN AG | ☐ | ☐ | ☐ |
| **LIONEL MESSI** FC BARCELONA | ☐ | ☐ | ☐ |
| **CRISTIANO RONALDO** FC REAL MADRID | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |
| | ☐ | ☐ | ☐ |

| VËREJTJET / PRIMEDBE / VEREJTJE | Kryesues i KVV-së: Član OBM: OKYK Başkanı: | Anëtar i KKZ-së: Član OIK-a: BSK üyeleri: | Zyrtari i pranimit në QNR: Službenik za prijem u CPR: SSM kabul görevlisi: |
|---|---|---|---|
| | Emri, Mbiemri \| Ime, Prezime \| Adı, soyadı | Emri, Mbiemri \| Ime, Prezime \| Adı, soyadı | Emri, Mbiemri \| Ime, Prezime \| Adı, soyadı |
| | | | |
| | Data \| Datum \| Tarih | Data \| Datum \| Tarih | Data \| Datum \| Tarih |
| | | | |
| | Nënshkrimi \| Potpis \| İmza | Nënshkrimi \| Potpis \| İmza | Nënshkrimi \| Potpis \| İmza |
| | | | |

Shtojca 8: Raporti i qendrës së numërimit dhe të rezultateve mbi pranimin e materialeve

## RAPORTI I QENDRËS SË NUMËRIMIT DHE TË REZULTATEVE MBI PRANIMIN E MATERIALEVE
## IZVEŠTAJ CENTRA ZA PREBROJAVANJE I REZULTATE O PRIMANJU MATERIJALA

KOMUNA / OPŠTINA

Numri i vendvotimit
Broj biračkog mesta

# RAPORTI I QENDRËS SË NUMËRIMIT DHE TË REZULTATEVE MBI PRANIMIN E MATERIALEVE / IZVEŠTAJ CENTRA ZA PREBROJAVANJE I REZULTATE O PRIMANJU MATERIJALA

Numri i vendvotimit: / Broj biračkog mesta: ☐☐☐☐☐ / ☐☐☐

## DËRGESA NGA KKZ / ISPORUKA IZ OIK-a

| Zarfi për Qendrën e numërimit dhe të rezultateve / Koverat za Centar za prebrojavanje i rezultate | ☐ | VËREJTJET / PRIMEDBE |
|---|---|---|
| Libri i votimit / Knjiga o toku glasanja | ☐ | |
| Lista përfundimtare e votuesve / Konačni birački spisak | ☐ | |
| FPR (Formulari i Përputhjes dhe Rezultateve) / OUR (Obrazac za Usklađivanje i Rezultate) Fleta e punës+origjinali+kopja e bardhë / Radni list+original+bela kopija — Kryetari i Komunës / Gradonačelnik | ☐ | |
| FPR (Formulari i Përputhjes dhe Rezultateve) / OUR (Obrazac za Usklađivanje i Rezultate) Fleta e punës+origjinali+kopja e bardhë / Radni list+original+bela kopija — Kuvendi Komunal / Skupština Opštine | ☐ | |
| FRK (Formulari i Rezultateve të Kandidatëve) / ORK (Obrazac za Rezultate Kandidata) Origjinali+kopjet / Original+kopija | ☐ | |
| FLIK (Fletët e përdorura përllogaritëse të kandidatëve) / LOGK (Korišćeni listovi za obračunavanje glasova kandidata) Kopjet / Kopija | ☐ | |

| Kutia e votimit të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës / Glasačka kutija za Izbore za Predsednika Opštine | ☐ | |
|---|---|---|
| A janë të saktë numrat e shiritave mbyllës? / Da li su brojevi zaštitnih pečata tačno upisani? | ☐ | |

Nëse janë ndryshuar, shënoni këtu numrat e shiritave mbyllës të përkohshëm / Ako su zaštitni pečati promenjeni, upišite brojeve privremenih zaštitnih pečata

| Kutia e votimit të Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal / Glasačka kutija za Izbore za Skupštinu Opštine | ☐ | |
|---|---|---|
| A janë të saktë numrat e shiritave mbyllës? / Da li su brojevi zaštitnih pečata tačno upisani? | ☐ | |

Nëse janë ndryshuar, shënoni këtu numrat e shiritave mbyllës të përkohshëm / Ako su zaštitni pečati promenjeni, upišite brojeve privremenih zaštitnih pečata

| Përfaqësuesi i KKZ-së / Predstavnik OIK-a | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri / Ime i prezime | |
| Nënshkrimi / Potpis | |
| Data / Datum | |

| Zyrtari i Qendrës së numërimit dhe të rezultateve / Službenik Centra za prebrojavanje i rezultate | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri / Ime i prezime | |
| Nënshkrimi / Potpis | |
| Data / Datum | |

| Nëse vendvotimi është i dyfishtë / Ako je dvojno biračko mesto | ☐ |
|---|---|
| Lista e votuesve me kusht / Uslovni birački spisak | ☐ |
| Thesi i fletvotimeve me kusht / Vreća sa uslovnim glasačkim listićima | ☐ |
| A janë të saktë numrat e shiritave mbyllës? / Da li su brojevi zaštitnih pečata tačno upisani? | ☐ |
| Numri i nënshkrimeve në LVK / Broj potpisa u UBS | ☐☐☐ |
| Numri i zarfave të fletëvotimeve me kusht (ZFK) / Broj koverata sa uslovnim glasačkim listićima (KUGL) | ☐☐☐ |

Nëse janë ndryshuar, shënoni këtu numrat e shiritave mbyllës të përkohshëm / Ako su zaštitni pečati promenjeni, upišite brojeve privremenih zaštitnih pečata

| Nëse vendvotimi është me nevoja të veçanta / Ako je biračko mesto sa posebnim potrebama | ☐ |
|---|---|
| Zarfi për Qendrën e Numërimit dhe rezultateve / Koverat za Centar za Prebrojavanje i Rezultate | ☐ |
| Kutia e ZFK-ve për VPNV / Kutija KUGL-a za OGPP | ☐ |
| A jane të saktë numrat e shiritave mbyllës? / Da li su ispravni brojevi traka za zatvaranje? | ☐ |
| Libri i votimit / Knjiga o toku glasanja | ☐ |
| Lista e votuesve me kusht / Uslovni birački spisak | ☐ |
| Formulari i përputhjes për VPNV / Obrazac za usklađivanje za OGPP | ☐ |
| Numri i nënshkrimeve në LVK / Broj potpisa u UBS | ☐☐☐ |
| Numri i zarfave të fletëvotimeve me kusht për VPNV / Broj koverata sa uslovnim glasačkim listićima za OGPP | ☐☐☐ |

Nëse janë ndryshuar, shënoni këtu numrat e shiritave mbyllës të përkohshëm / Ako su zaštitni pečati promenjeni, upišite brojeve privremenih zaštitnih pečata

**MATERIALET QË MUNGOJNË**
**(përshkrimi i arsyeve për mungesën e materialeve, dhe hapat që janë ndërmarrë)**
**MATERIALI KOJI NEDOSTAJU**
**(opis razloga za izgubljene materijale, preduzete aktivnosti)**